



## Republika e Maqedonisë MINISTRIA E DREJTËSISË

Në bazë të nenit 35 nga Rregullorja Gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/13 dhe 114/14), Ministria e Drejtësisë publikon

### SHPALLJE

#### **Për kontrollimin e njohurive të kandidatëve për përkthyes të përhershëm gjyqësor**

1. Kandidati i cili paraqitet dërgon **Kërkesë** me fletë pagesë për taksë administrative prej 50.00 denarëve, në të cilën shkruan të dhënat personale (emri, emri i babës, mbiemri, adresa e banimit, e-mail adresa, telefonin e të ngjashme) dhe për cilën/at gjuhë dëshiron të emërohet si përkthyes gjyqësor. Në bashkëngjitje të Kërkesës është i obliguar të dërgon edhe:
  - Certifikatë mbi shtetësinë
  - Dëshmi për vendbanimin ose vendqëndrimin në rajonin e gjykatës, për të cilin kërkon të vendoset për përkthyes (fotokopje nga letër njoftimi ose vërtetim për vendqëndrimin);
  - Certifikatë ose diplomë për arsim të mbaruar të lartë;
  - Vërtetim nga institucion i lartë arsimor për njohjen aktive të gjuhës maqedonase (vetëm përderisa arsimi i lartë është kryer jashtë Republikës së Maqedonisë);
  - Certifikatë ose vërtetim për njohjen aktive të gjuhës së huaj ose gjuhën e pjesëtarëve të bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë;
  - Fletëpagesë.
2. Secili kandidatët duhet të dorëzojë **fletëpagesë** në shumë prej **6,000,00 denar**, të paguar në xhironlogarinë e Ministrisë së Drejtësisë, numër **070010014063112** me **shënim "Për kontrollimin e njohurive për përkthyes gjyqësor"**, emri i pranuesit – **Ministria e Drejtësisë**, banka e pranuesit - **Banka Popullore e RM**, llogaria e thesarit të Bankës Popullore nr. **100000000063095**, shifra e të hyrave **723013**, programi **10**.
3. Dokumentet e nevojshme duhet të jenë origjinale ose kopje të vërtetuara te noteri (përveç letër njoftimit) dhe së bashku me Kërkesën të dërgohen në arkivin e **Ministrisë së Drejtësisë, rr. Dimitrie Çupovski, nr. 9 – Shkup**.
4. Kontrollimi i njohurive kryhet me shkrim dhe me gojë, në pajtim me Programin për kontrollimin e njohurive të gjuhës tjetër për vendosjen e përkthyesve të përhershëm gjyqësor.
5. Programin dhe informatat e tjera për zbatimin e procedurës për kontrollimin e njohurive janë të publikuara në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë – [www.pravda.gov.mk](http://www.pravda.gov.mk).
6. Pjesa me shkrim nga kontrollimi i njohurive do të mbahet më **14.04.2018 (e shtunë)**, me **fillim në ora 09:00**, në hapësirat e **Gjykatës së Apelit në Shkup**.
7. Kandidati i cili do ta kalon pjesën e provimit me shkrim për njohjen e gjuhës së huaj, i nënshtrohet pjesës me gojë më së voni në afat prej **7 ditëve** pas zbatimit të pjesës me shkrim.
8. Shpallja zgjatë **15 ditë** nga dita e publikimit.

**Ministria e Drejtësisë**